

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“DEVIS CONSTRUCTION” Sh.P.K.

Ne Fier sot me date 22/02/2018 (dy mije e Tetembedhete) ne ortaket e shoqeris” DEVIS”shpk hartuam statusin per shoqerine e mesiperme sh.p.k te perbere nga dy ortake **Fetije Kripa** , e bija e Ymerit , shtetase shqiptare , lindur me 24/11/1956 ne Kuqar,Fier e banuese ne Patos,Dukas ,madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, me nr personal F66124053C

Aleksander Kadria ,i biri i Shuaipit shtetas Shqiptare lindur me 17/04/1982 ne Patos ,Fier dhe banues ne Tirane me nr personal I20417081K

Te cilet ne cilesine e «ortakeve themelues», me vullnet të lire, të plote e të singerte, mbeshtetur ne inisiativen e lire private, Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, miratuar me Ligjin nr. 7850, date 29.7.1994, i ndryshuar, ne Ligjin 9901, date 14.04.2008, “Per tregtarët dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar, ne Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, i ndryshuar, me kerkoi redaktimin e ketij statuti te shoqerise tregtare me pergjegjesi të kufizuar: “ DEVIS ” Sh.p.k (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, më 22/02/2018 (dy mije e Ttetembedhete), une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “ **DEVIS CONSTRUCTION**” Sh.P.K.

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

Znj.Fetije Kripa ,shtetase shqiptare , lindur me 24/11/1956 ne Kuqar,Fier e banuese ne Patos,Dukas, Fier me nr personal F66124053C

Z.Aleksander Kadria ,i biri i Shuaipit shtetas Shqiptare lindur me 17/04/1982 ne Patos ,Fier dhe banues ne Tirane me nr personal I20417081K

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- **Tregeti materiale ndertimi.Pergatitje dhe kthim hekuri dhe kryerje punime ne ndertim.Tregetim materiale elektrike ,hidraulike,kancelari.dru zjarri dhe materiale**

te ndryshme,import-eksport,transport mallrash per vete dhe per te trete e me qera,investim ne Ndretime.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Patos, Fshati Dukas, Rr. Patos-Dukas, Km3 Banesa Nr 15/2

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100, 000 (njemilion mije) Lekë.
- (2) Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtem:
- (3) Kapitli themeltar është i ndare në 2- kuota

Ortaku themelues **Fetije Kripa**: Zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 80,000 (tetedhjet mij), që përben 80 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku tjetër **Aleksander Kadria**: Zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 20,000 (njzet mije leke)

Kontributi i ortakut është në para dhe është paguar tërësisht 100%

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit mund të bëhet vetëm me vendim të ortakut të vetëm, i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i vetem është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR-se per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

(1) Ortaket eshoqerise emërojne një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.


(2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator:

ZAleksander Kadria , lindur me 17/04/1982 ne ,Patos , Fier e banuese ne Tirane

-Specimeni i nënshkrimit:

Neni 10

Kompetencat e Administratorit



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakut të vetem për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara ortakut të vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin mbledhjen e Ortakut të vetem, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse ortaku i vetem emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Ortaku i vetem mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga ortaku i vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanëtojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakut kontributet;
- b) i paguan ortakut interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku i vetem ka të drejtë të ngrejë padi penale kundër administratorit.

Paditësi ka të drejtë të ndjek në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut te vetem.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per atë per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakut te vetem per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

Neni 14

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) me vendim të Ortakut të vetem;
- b) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- ç) me vendim të gjykatës;

Në këto raste Ortaku i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortaku i vetëm.

Nëse Ortaku i vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 15

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Ortakut të vetëm në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 18

Dispozita përfundimtare

Statuti u hartua në 4 (kater) ekzemplare origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore,

O R T A K E T E SHOQERISE
SHOQERIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUA
“DEVIS CONSTRUCTION “ SH.P.K

ALEKSANDER KADRIA



Fatjone Kupa
JK